



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

**Numri i lëndës:** KSC-BC-2020-07/IA004

**Vendosi:** Kryetarja e Dhomave të Specializuara  
Gjykatëse Ekaterina Trendafilova

**Administratore:** Fidelma Donlon

**Data:** 6 prill 2021

**Gjuha:** Shqipe

**Klasifikimi:** Publik

---

## Vendim për Caktimin e Panelit të Gjykatës së Apelit

---

### Gjykatësve të Panelit të Gjykatës së Apelit:

Gjykatëse Mishelë Pikar

Gjykatës Emilio Gati

Gjykatëse Kai Ambos

### Zyrës së Prokurorit të Specializuar:

Xhek Smith

### Mbrojtësve të Hysni Gucatit:

Xhonatan Elistan Ris

Hju Bauden

### Mbrojtësve të Nasim Haradinajt:

Tobi Kadman

Karl Bakli

**KRYETARJA** e Dhomave të Specializuara (“Kryetarja”), duke vepruar në bazë të neneve 33(1)(c) dhe 45(2) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, rregullave 77(1), 169 dhe 170(2) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“DHSK”) dhe rregullave 3 dhe 4 të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve të Dhomave të Specializuara nga Regjistri i Gjykatësve Ndërkombëtarë (“Rregullorja për Caktimin e Gjykatësve”), me anë të këtij vendimi cakton një panel të Gjykatës së Apelit në vijim të vendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake për miratimin e kërkesave të z. Hysni Gucati dhe z. Nasim Haradinaj për leje për apelimin e vendimit mbi mocionet e tyre paraprake lidhur me mangësitë e aktakuzës së konfirmuar (“Vendim për Miratimin e Lejes për Apelim”)<sup>1</sup>.

## I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 25 dhe 26 shtator 2020, z. Gucati dhe z. Haradinaj u arrestuan në Kosovë dhe u transferuan në objektin e paraburgimit të DHSK-së në Hagë, Holandë.<sup>2</sup>
2. Më 11 dhjetor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konfirmoi aktakuzën kundër z. Gucati dhe z. Haradinaj, pjesërisht, dhe urdhëroi, ndër të tjera, Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) të dorëzonte një “aktakuzë të rishikuar për herë të dytë”, të konfirmuar.<sup>3</sup>
3. Më 14 dhjetor 2020, ZPS-ja dorëzoi aktakuzën e konfirmuar.<sup>4</sup>
4. Më 8 mars 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake i hodhi poshtë në tërësi mocionet paraprake të parashtruara nga z. Gucati dhe z. Haradinaj me anë të cilëve ata pretendonin, ndër të tjera, se aktakuza përmbante mangësi (“Vendimi i Kundërshtuar”).<sup>5</sup>

5. Më 15 mars 2021, z. Haradinaj dhe z. Gucati kërkuan leje që të apelonin Vendimin e Kundërshtuar.<sup>6</sup>

6. Më 1 prill 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nxori Vendimin për Miratimin e Lejes për Apelim.<sup>7</sup>

## II. CAKTIMI

7. Pas shqyrtimit të kriterëve të parashikuara në rregullën 4(2) të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve, duke përfshirë përvojën dhe kompetencën përkatëse, si edhe disponueshmërinë në këtë moment,

### KRYETARJA ME KËTË VENDIM CAKTON:

**Gjykatësen Mishelë Pikar**

**Gjykatësin Emilio Gati**

**Gjykatësin Kai Ambos**

në panelin e Gjykatës së Apelit për të vendosur për apelet e ngritura në përputhje me Vendimin për Miratimin e Lejes për Apelim.

---

<sup>1</sup> F00235, Vendim mbi Kërkesat e Mbrojtjes për Leje për Apelimin e Vendimit mbi Mocionet Paraprake të Mbrojtjes, 1 prill 2021.

<sup>2</sup> Shih F00012, Vendim mbi Kërkesën për Fletarrestime dhe Urdhra Transferimi, 24 shtator 2020.

<sup>3</sup> F00074/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit për Konfirmimin e Aktakuzës, 11 dhjetor 2020, para. 155.

<sup>4</sup> F00075, Parashtrim i Aktakuzës së Konfirmuar me Shtojcat Rreptësisht Konfidenciale 1 dhe 2, 14 dhjetor 2020.

<sup>5</sup> F00147, Vendim mbi Mocionet Paraprake të Mbrojtjes, 8 mars 2021, para. 74.

<sup>6</sup> Shih F00151, Kërkesë për Leje për Apelim të Vendimit KSC-BC-2020-07/F00147 sipas nenit 45(2) dhe rregullës 77(1), 15 mars 2021; F00153 Kërkesë për Leje për Apelim të Vendimit KSC-BC-2020-07/F00147 sipas nenit 45(2) dhe rregullës 77(1), 15 mars 2021.

<sup>7</sup> Shih Vendim për Miratimin e Lejes Për Apelim.

/nënshkrimi/

---

**Gjykatëse Ekaterina Trendafilova**  
**Kryetare e Dhomave të Specializuara**

E martë, 6 prill 2021  
Hagë,  
Holandë